

KONFERENCA KOMBËTARE

“RISITË DHE PROBLEMATIKAT E ZBATIMIT PËR HERË TË PARË TË SKK TË PËRMIRËSUARA”

Tiranë, 7 QERSHOR 2016

ZBATIMI I SKK DHE NEVOJA E HARMONIZIMIT TË RAPORTIMIT FINANCIAR ME ATË FISKAL

Të nderuar kolegë

Kam kënaqësinë që në emër të anëtarësisë së IKM të shpreh falenderimet e veçanta për organizatorët e kësaj konference kombëtare dhe që më dhanë mundësinë të shkëmbej me ju disa pikëpamje dhe këndvështrime për zbatimin e SKK-ve në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë të zbatimit për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara të cilat hynë në fuqi në përgatitjen e pasqyrave financiare të publikueshme për vitin ushtrimor që mbyllet në 31 dhjetor 2015.

SKK janë e vetmja paketë rregullash mbi të cilat mbështetet përgatitja e Pasqyrave Financiare të publikueshme për qëllime të përgjithshme për pjesën dërrmuese të njësive ekonomike rezidente në vendin tonë (përveç njësive ekonomike me interes publik që kanë një paketë tjetër rregullash). Kjo paketë u hartua në përputhje me SNK dhe SNRF në fuqi në një nivel më të thjeshtuar. Pas një periudhe gati 10-vjeçare nga miratimi dhe 8 vjet nga zbatimi mund të themi se përveç problematikave të vogla raportimi financiar i bazuar në këto standarde ka patur një zhvillim të konsiderueshëm, ku për herë të parë janë përdorur koncepte të tilla si vlera e drejtë, shuma e rikuperueshme dhe vlera neto e realizueshme, janë përdorur për herë të parë veprime dhe veprimtari të tilla si qiraja financiare, kombinimi i bizneseve, provizionet dhe grantet, dhe për herë të parë kërkohej një paketë më e plotë e pasqyrave financiare e cila përfshinte pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto. Megjithatë pas një periudhe relativisht të gjatë ku mund të themi se zbatimi i SKK u konsolidua, ndryshimet në vijimësi që ka pësuar kuadri rregullator për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, dhe në mënyrë të veçante hartimi i SNRF për SME dhe direktiva e re për kontabilitetin, solli

nevojën e rishikimit të SKK ekzistuese për të qënë sa më afër këtyre ndryshimeve dhe për të korigjuar ose për të përmirësuar disa nga problemet në zbatimin korrekt dhe me koherencë të SKK. Ndryshime ka patur pothuajse në të gjitha SKK ekzistuese por ndryshime thelbësore ka pësuar SKK 2, në emërtimin e Pasqyrave Financiare, në formatin, përbërjen dhe përmbajtjen e tyre, SKK 5 ku trajtohen për herë të parë aktivet e investuara, aktivet e nxjerra për shitje dhe ndryshon trajtimi i kostove të huamarrjes dhe shpenzimeve të kërkim-zhvillimit, një ristrukturim i plotë i SKK 9 dhe SKK 14, ndryshimi i trajtimit kontabël të emrit të mirë që lind në një kombinim biznesesh apo trajtimi për herë të parë i sipërmarrjeve të përbashkëta dhe i njësive me qëllim të veçantë. Ndryshime kanë ndodhur edhe në SKK 10 në trajtimin e granteve, SKK 13 në trajtimin e aktiveve biologjike dhe përfshirja për herë të parë në këtë standard dhe në të gjithë kuadrin rregullator e trajtimit kontabël të konçesioneve. Por ndryshimi që në këndvështrimin tonë përbën një risi dhe transformim rrënjësor të rregullimit ekzistues dhe të ndërthurjes së rregullimit fiskal në raportimin financiar të njësive ekonomike është zbatimi i detyrueshëm për herë të parë i SKK 11, Tatimi mbi fitimin, dhe i konceptit të tatimit të shtyrë mbi fitimin. Ne mendojmë se zbatimi i detyrueshëm i këtij standardi sjell një paraqitje më të drejtë dhe më të saktë të ngarkesës dhe kostos reale që ka njësia ekonomike për tatimin mbi fitimin dhe i bën të krahasueshme pasqyrat financiare të njësive ekonomike nga kjo pikëpamje. Zbatimi i këtij standardi mund të konsiderohet i vështirë por të paktën me anëtarët e organizatës sonë profesionale besojmë se e kemi tejkaluar këtë vështirësi nëpërmjet trajnimeve dhe udhëzimeve për zbatimin e këtij standardi.

Me zbatimin e këtij standardi ne mendojmë se rregullohet përfundimisht edhe qasja herë herë e pakuptueshme që përgatitja e pasqyrave financiare orientohet në shumë njësi ekonomike nga kërkesat dhe rregullat fiskale, në rastin më të mirë për të qënë në rregull me administratën tatimore dhe në rastin më të keq për të deformuar me dashje situatën dhe performancën e vërtetë financiare të tyre.

Gjithashtu zbatimi i këtij standardi, por jo vetëm, kërkon në mënyrë të menjëhershme kalimin nga situata e përgatitjes së pasqyrave financiare për të plotësuar vetëm kërkesat për informacion të administratës tatimore drejt përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare

sipas SKK për qëllime dhe kërkesa të përgjithshme. Kështu p.sh. njësitë ekonomike kanë më shumë mundësi në përzgjedhjen e metodave të amortizimit të aktiveve dhe të trajtimit të shpenzimeve të mëpasshme për këto aktive, mund të njohin, vlerësojnë dhe paraqesin provizione dhe shuma të tjera të parashikuara për zhvlerësim në Pasqyrat Financiare, mund t'i trajtojnë grantet si të ardhura kur përmbushen kushtet e performancës, dhe të tjera mundësi që kanë tani njësitë ekonomike për të paraqitur pamjen reale të njësisë nga pikëpamja e pozicionit dhe performancës financiare dhe jo një pamje që nuk reflekton në asnjë rast zbatimin e rregullave kontabël por vetëm ato fiskale. Një pamje e cila paraqet situatën reale jo vetëm për të siguruar informacion të besueshëm për të gjithë kategoritë e investitorëve por dhe vetë për njësitë e administrimit fiskal dhe agjensitë e tjera qeveritare.

Njësitë ekonomike duhet të shfrytëzojnë edhe mundësinë që i jep legjislacioni tatimor që njeh vetëm kuadrin rregullator të SKK për raportimin e transaksioneve dhe ndërtimin e pasqyrave financiare. E vetmja pikë që bashkon kërkesat e raportimit financiar me atë fiskal është llogaritja e shumës aktuale për t'u paguar (ose arkëtuar) e tatimit mbi fitimin duke rillogaritur bazën e tatueshme të fitimit.

Ndaj do të propozonim që çdo njësi ekonomike të përgatisë vetëm një paketë të plotë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe SKK. Njësitë ekonomike të furnizojnë me informacion specific përdorues të veçantë si p.sh. organet tatimore, bankat, INSTAT, etj., që do të kishin kërkesa të veçanta në lidhje me pasqyrat financiare dhe raportimin financiar në tërësi. Vetëm në këtë mënyrë do të realizohet objektivi i pasqyrave financiare për një paraqitje sa më të besueshme dhe të rëndësishme të realitetit financiar, vetëm në këtë mënyrë njësitë ekonomike do të rrisnin kredibilitetin e tyre në sytë e përdoruesve të informacionit, vetëm në këtë mënyrë do të përmirësohet cilësia e raportimit financiar të njësive ekonomike duke dhënë një garanci për investitorët dhe vetë zhvillimin ekonomik të vendit.

Julian Naqellari

President i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar